




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM



Nr. 1311/2 Prot.

Lënda: Dërgim rezolute

Tiranë më 20.07. 2022

INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Rezolutë “Për vlerësimin e veprimitarise së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2021”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONÇAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË
TË DREJTËSISË PËR VITIN 2021**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë;

Duke mbajtur parasysh rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në hetimin e shkeljeve të dyshuara nëpërmjet ankesave të paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, por edhe kryesisht bazuar në të dhëna publike ose të siguruara në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorin e Përgjithshëm në kuadër të përbushjes së detyrave funksionale;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë,

Vlerëson punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në drejtim të:

Nisjes së shqyrtimit fillestare të një numri të madh ankesash lidhur me veprimtarinë e magjistratëve, organizimin e burimeve njerëzore, si dhe nisjes së procesit të rekrutimit të inspektorëve dhe statit të Zyrës.

Zhvillimit të një numri të konsiderueshëm të hetimeve disiplinore ndaj magjistratëve brenda viti kalendarik 2021.

Raportimeve të detajuara vjetore dhe periodike, si dhe informimeve drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe Kuvendit të Shqipërisë lidhur me aktivitetin e institucionit.

Angazhimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përgatitjen e kuadrit rregullues të veprimtarisë institucionale në zbatim të nenit 204, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Bazuar në analizën e të dhënave, të referuara në raportin e paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për vitin 2021, Kuvendi i Shqipërisë konstaton:

Marrjen e 22 vendimeve për fillimin e hetimit disiplinor për 31 subjekte të hetimit disiplinor.

Hartimin dhe miratimin e 33 urdhrove të përgjithshëm me karakter administrativ dhe rregulator, që kanë të bëjnë me çështje të organizimit dhe funksionimit, menaxhimit e kontrollit finansiar, sinjalizimit dhe sigurisë së të dhënave dhe informacionit.

Raportimet e detajuara vjetore dhe periodike, si dhe informacionet drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe Kuvendit të Shqipërisë për aktivitetin e institucionit.

Marrjen e 2 vendimeve për inspektimet tematike sipas përcaktiveve ligjore.

Përfitimin e statusit të vëzhguesit pranë Rrjetit European të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë.

Bashkëpunimin me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Ministrinë e Drejtësisë, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë.

Pjesëmarrjen në një numër të lartë trajnimesh nga ekspertë ndërkombëtarë dhe kombëtarë për rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të Zyrës.

Angazhimin në ndërveprim me qytetarët nëpërmjet informimeve periodike, pasurimit informativ të faqes, si dhe angazhimin e Sektorit të Ndihmës Juridike dhe Ankesave.

Ndërtimin e bazës statistikore mbi të dhënat e përgjithshme për ankesat ku përfshihen detajime me interes informativ dhe studimor lidhur me grup-moshat e ankuesve, shkeljeve të pretendoara nga ankuesi dhe ankesat e trajtuarë sipas objektit të padisë etj.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka adresuar nevojën për disa ndryshime ligjore që i shërbejnë mirëfunkcionimit të veprimtarisë së institucionit dhe rritjes së eficencës së inspektiveve.

Bazuar sa më sipër, Kuvendi i Shqipërisë nxit Inspektorin e Lartë të Drejtësisë:

1. Të veprojë me ritme të shpejta për shqyrtimin e ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Të forcojë më tej bashkëpunimin me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe institucionet e tjera shtetërore në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të gjitha proceset që ndikojnë në zbatimin e detyrave të përcaktuara në ligj.

3. Të informojë vazhdëmisht Kuvendin e Shqipërisë për problematikat e hasura gjatë ushtrimit të detyrave duke rekomanduar edhe zgjidhjet përkatëse.

Kuvendi i rekomandon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:

1. Hartimin e dispozitave të hollësishme për administrimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve për procedurën hetimore, si dhe bërjen publik të informacionit të pështëm sipas përcaktimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përputhje dhe në zbatim të nenit 137 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Vijimin me ritme të shpejta të punës për hartimin e rregullores për trajtimin e ankesave dhe hartimin e një metodologje të përgjithshme inspektimi.

3. Vijimin me ritme të shpejta të punës për përfundimin e procedurave të rekrutimit të inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

4. Nxitjen e bashkëpunimit me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm ose institacione të tjera për paraqitjen e kërkesave të motivuara nga ana e tyre për realizimin e inspektimeve tematike apo institucionale nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

5. Hartimin dhe miratimin e planit vjetor të inspektimeve institucionale dhe tematike, si dhe bërjen publik të tij në faqen zyrtare të institucionit.

6. Vijimin me ritme të shpejta të trajtimit të ankesave të dorëzuara nga organet kompetente gjatë periudhës kalimtare, si dhe trajtimin me përparësi të ankesave, të cilat për shkak të parashikimeve të nenit 117 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” mund të parashkuhen, duke shmangur kështu arkivimin e tyre pa bërë të mundur verifikimin dhe hetimin nga institucioni.

7. Ndjekjen me prioritet të ankesave ndaj magjistratëve në proces vetingu në funksion të përgjegjshmërisë dhe llogaridhëniec së tyre.

8. Trajtimin me prioritet të gjitha rasteve të konfliktit të interesit që mund të ndeshen gjatë aktivitetit të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

9. Rishikimin e objektivave të punës dhe hartimin e një plani të ri strategjik, të shtrirë në kohë dhe sipas një metodologje të bashkërenduar për të shërbyer si një bazë për planifikim të përgjithshëm dhe për menaxhimin e performancës.

10. Angazhimin në kryerjen e kontrollit të brendshëm në mënyrë periodike, kryesisht në llogaridhëni e inspektorëve.

11. Vijimin dhe rritjen e transparencës ndaj publikut nëpërmjet përdorimit të kanaleve të ndryshme të komunikimit publik.

Miratuar në datën 14.7.2022